



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.16

2004

26 mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9190 datë 19.2.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane plotësuese të Konventës “Për shenjat dhe sinjalet rrugore” (Gjenevë, 1 maj 1971)	763
Ligj nr.9191 datë 19.2.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit të projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit të Zhvillimit Shqiptar, si agjenci e zbatimit të projektit dhe Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) për projektin “Fondi i investimeve sociale-III””	771
Ligj nr.9192 datë 19.2.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë mbi bashkëpunimin ushtarak”	778
Ligj nr.9193 datë 19.2.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë”	781
Ligj nr.9194 datë 19.2.2004	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”	785
Ligj nr.9197 datë 26.2.2004	Për ratifikimin e “Konventës nr.171 “Mbi punën e natës”, 1990 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”	790

L I G J
Nr.9190, datë 19.2.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN EUROPIANE
PLOTËSUESE TË KONVENTËS “PËR SHENJAT DHE SINJALET RRUGORE”
(GJENEVË, 1 MAJ 1971)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen Europiane plotësuese të Konventës “Për shenjat dhe sinjalet rrugore” (Gjenevë, 1 maj 1971).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4169, datë 15.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJA

**EUROPIANE QË PLOTËSON KONVENTËN MBI SHENJAT DHE SINJALET RRUGORE
(E hapur për firmosje në Vjenë më 8 nëntor 1968 bërë në Gjenevë më 1 maj 1971)**

ANEKS

1. Për qëllimet e këtij aneksi, termi "Konventë" nënkupton Konventën mbi shenjat dhe sinjalet rrugore e hapur për firmosje në Vjenë më 8 nëntor 1968.

2. Ky aneks përmban vetëm plotësimet dhe modifikimet e parashikimeve korresponduese të Konventës.

3. Shtesë në nenin 1 të Konventës (Termat)

Nënparagrafi c

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Zonë e ndërtuar" nënkupton një zonë me hyrje dhe dalje të shënuara me postera në mënyrë speciale si të tilla.

Nënparagrafi shtesë të shtohet menjëherë pas nënparagrafit (c) të këtij neni.

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Zonë rezidenciale" nënkupton një zonë të projektuar në mënyrë të veçantë, ku zbatohen rregulla speciale trafiku dhe e cila është shënuar me postera si e tillë në hyrjet dhe daljet e saj.

Nënparagrafi (n)

Automjetet me tre timona, masa e panjohur e të cilëve nuk tejkalon 400 kg, do të konsiderohen si motoçikleta.

Nënparagrafi shtesë të vendoset në fund të këtij neni.

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Persona që tërheqin ose shtyjnë një karrocë

fëmijësh, një karrige plazhi ose karrige invalidi ose çdo mjet tjetër të vogël pa motor, ose që shtyjnë një biçikletë ose një person handikapatë që udhëton me karrige invalidësh e lëvizur nga persona të tillë ose që lëviz me tempin e shëtijes do të trajtohet si udhëtar.

4. Shtesë në nenin 3 të Konventës (Detyrimet e Palëve Kontraktuese)

Paragrafi 4

Masat e referuara në këtë paragraf nuk do të mundën as të modifikojnë qëllimin e nenit 39 të Konventës dhe as të bëjnë parashikimet që përmban ai më optimale.

5. Shtesë në nenin 6 të Konventës (Udhëzime të dhëna nga nëpunës të autorizuar)

Paragrafi 3

Parashikimet e këtij paragrafi të cilat janë rekomandimet në Konventë, do të jenë të detyrueshme.

6. Shtesë në nenin 7 të Konventës (Rregulla të përgjithshme)

Paragrafi 2

Parashikimet e këtij paragrafi të cilat janë rekomandimet në Konventë, do të jenë të detyrueshme.

Paragrafi shtesë të vendoset në fund të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Legjislacioni kombëtar duhet të bëjë rregulla si për përdorimin e rripave të sigurisë ose pajisjeve të ngjashme nga fëmijët, si dhe të transportit të fëmijëve në vendet përpara".

7. Shtesë në nenin 8 të Konventës (Shoferët)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë që kafshët e paketuara të konservuara ose bruto dhe me përjashtim në disa zona speciale që mund të shënohen në hyrjet e tyre, macet në grup ose kope, do të kenë një shofer të aftë për të drejtuar kafshët gjatë gjithë kohës."

Paragrafi 5

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Çdo shofer do të ketë automjetin e tij nën kontroll që të jetë në gjendje për të ushtruar kujdesin e duhur dhe përkatës gjatë gjithë kohës. Ai duhet të jetë i njohur me rregullat e trafikut rrugor dhe sigurisë dhe të ketë kujdes nga faktorët të cilët mund të ndikojnë në qëndrimin e tij, siç janë sëmundja, marrja e ilaçeve dhe drejtimi i mjetit nën influencën e alkoolit ose pijeve të tjera."

Paragrafi shtesë vendoset menjëherë pas paragrafit 5 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Legjislacioni kombëtar duhet të krijojë parashikime specifike në lidhje me drejtimin e mjetit nën influencën e alkoolit dhe të përcaktojë një nivel ligjor të alkoolit në gjak, nëse duhet, edhe nivelin e frymës së alkoolit, kompatibël për drejtimin e mjetit. Sipas legjislacionit kombëtar niveli maksimal i alkoolit në asnjë rast nuk duhet të kalojë 0.80 g për një litër alkool puro në gjak ose 0.4 mg për litër në dhënien e frymës."

8. Shtesë në nenin 9 të Konventës

Parashikimet e këtij paragrafi të cilat janë rekomandimet në Konventë, do të jenë të detyrueshme.

9. Shtesë në nenin 10 të Konventës (Pozicioni në rrugën e transportit)

Titulli duhet të lexohet si vijon: "Pozicioni në rrugë".

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë pas paragrafit 1 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon:

"a) Me përjashtim të rasteve të nevojës absolute, çdo shofer do të marrë ekskluzivisht, kur ato ekzistojnë, rrugët, rrugët e transportit, korridorin ose korsinë e caktuar për përdoruesit e rrugës së kategorisë së tij."

"b) Kur nuk u është caktuar ndonjë rrugë ose korsë, shoferët e motorëve, mjeteve pa motor, mundet të udhëtojnë gjatë çdo hapësire të kënaqshme në drejtimin e trafikut, nëse kjo mund të bëhet pa shkakuar ndikim të përdoruesit e tjerë të rrugës."

10. Shtesë në nenin 11 të Konventës (Parakalimi dhe lëvizja e trafikut në radhë)

Paragrafi 5, nënparagrafi (b)

Ky parashikim nuk do të zbatohet.

Paragrafi 6, nënparagrafi (b)

Si rezultat i moszbatimit të nënparagrafit 5 të këtij neni parashikimet e frazës së fundit të këtij nënparagrafi nuk do të zbatohen."

Paragrafi 8, nënparagrafi (b)

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Menjëherë përpara ose në një mbikalim të papajisur me porta ose gjysmëporta, përveçse kur trafiku rrugor është i rregulluar me sinjale trafiku me drita siç përdoret në kryqëzimet."

Paragrafi 11

Ky paragraf do të lexohet si vijon:

"a) Në zonat e ndërtuara, në rrugët e transportit ku së paku dy kalime janë rezervuar për trafikun në një drejtim dhe janë treguar me shenja gjatësore, parashikimet e nenit 10 paragrafi 3 i Konventës nuk do të zbatohet; shoferët e mjeteve motorike mund të përdorin vijën më të mirë që përputhet me destinacionin e tyre. Ata do të ndryshojnë vijën vetëm kur përgatiten të kthehen djathtas ose majtas, të parakalojnë, të qëndrojnë ose të parkojnë në përputhje me rregullat që udhëheqin manovrën."

"b) Në rastin (a) të përmendur më sipër, mjetet në linjën që korrespondojnë me drejtimin e trafikut që janë duke lëvizur më shpejt sesa ato në vijat e tjera nuk do të konsiderohen sikur parakalojnë për qëllimet e këtij neni. Megjithatë, parashikimet e paragrafit 9 të këtij neni do të mbeten në zbatim."

"c) Nënparagrafi (a) më sipër nuk do të jetë në zbatim në rrugët motorike dhe në rrugët e tjera, përveç motorikëve të cilët janë rezervuar për trafikun e mjeteve motorike, i treguar qartë me postera si i tillë dhe që nuk ndihmon hyrjen për ose nga pikat ngjitur, ose në çdo rrugë ku shpejtësia tejkalon 80 km (50 milje) në orë është i lejuar."

11. Shtesë në nenin 12 të Konventës (Kalimi i trafikut që shkon)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Në rrugët malore dhe të shkallëzuara me karakteristika të ngjashme me ato malore, ku kalimi i trafikut që shkon është i pamundur ose i vështirë, është shoferi i automjetit që udhëton për poshtë, i cili duhet të kalojë në anën e rrugës, me qëllim që të ndihmojnë çdo mjet që vazhdon në ngjitje për të kaluar, me përjashtim kur ka rregullime për të lejuar mjetet të kalojnë në anë të tilla, që kanë marrë parasysh shpejtësinë dhe pozicionin e automjetit, mjetet që vazhdojnë në ngjitje ka një vend përpara tij dhe nevojës që një automjet të kthehet duhet të shmanget nëse automjeti në ngjitje futet në këtë vend. Kur një nga dy mjetet të cilët pothuaj janë në shkëmbim është i detyruar të kthehet në mënyrë që të hapë vend, automjeti i kombinuar do të ketë të drejtën e kalimit mbi çdo mjet tjetër, automjetet e rënda mbi ato të lehta dhe autobusat mbi kamionat; kur të dy automjetet janë të së njëjtës kategori është shoferi i automjetit në zbritje që duhet të kthehet, përveçse kur është e lehtë për shoferin e mjetit në ngjitje që të veprojë, për shembull, nëse ky i fundit është pranë një vendi."

12. Shtesë në nenin 13 të Konventës (Shpejtësia dhe distanca ndërmjet automjeteve)

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Çdo shofer i një mjeti, kur rregullon shpejtësinë e mjetit të tij, do t'i duhet t'u kushtojë vëmendje rrethanave, në veçanti formës së tokës, gjendjes së rrugës, kushteve dhe ngarkesës së mjetit të tij, konditave të kohës dhe densitetit të trafikut, në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të ndalojë mjetin e tij brenda distancës së shikimit përpara dhe pengesave të paparashikuara. Ai do të ngadalësojë dhe nëse është e nevojshme, të ndalojë kurdoherë që rrethanat e kërkojnë dhe në veçanti kur shikimi nuk është i mirë."

Paragrafi 4

Ky paragraf, duke përfshirë dhe nënparagrafët (a) dhe (b) do të vijojë: "Jashtë zonave të ndërtuara, në rrugët ku është caktuar vetëm një vijë për trafikun në drejtimin e interesuar, me qëllim të lehtësimit të parakalimit, shoferët e automjeteve të cilët janë subjekt i kufizimeve speciale të shpejtësisë dhe shoferët e mjeteve ose të mjeteve të kombinuara të më shumë se 7 m në gjatësinë e përgjithshme, me përjashtim kur ata janë duke parakaluar ose po përgatiten për parakalim, do të mbajnë distancën e tillë nga automjete me motor që janë përpara, që automjete të tjera që parakalojnë ato të munden pa asnjë rrezik të lëvizin në hapësirën përpara automjetit që parakalohet."

Megjithatë, këto parashikime nuk do të zbatohen në një trafik me shumë densitet ose në rrethana ku parakalimi është i ndaluar."

13. Shtesë në nenin 14 të Konventës (Kërkesa të përgjithshme që drejtojnë manovrën)

Paragrafi 1

Ky parashikim do të lexohet si vijon: "Çdo shofer që dëshiron të kryejë një manovër, siç është dalja ose hyrja në një vijë të parkimit, duke lëvizur në të djathtë ose në të majtë në rrugën e transportit, në veçanti me qëllim të ndryshimit të vijës, ose të kthimit majtas ose djathtas në një rrugë tjetër ose në bordurën kufizuese të rrugës, përpara do të sigurohen që ata mund të veprojnë kështu pa asnjë rrezik për automjetet e tjera që lëvizin prapa ose përpara tyre për t'i kaluar ata, duke pasur në konsideratë pozicionin e tyre, drejtimin dhe shpejtësinë."

14. Shtesë në nenin 15 të Konventës (Rregulla speciale në lidhje me automjetet e shërbimeve të rregullta të transportit publik)

Parashikimet e këtij neni i cili është një rekomandim në Konventë, të jenë të detyrueshme.

15. Shtesë në nenin 18 të Konventës (Kryqëzimi dhe detyrimi për të hapur rrugën)

Paragrafi 3

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Çdo shofer që futet në një rrugë nga një bordurë kufizuese, do t'u hapë rrugë përdoruesve që udhëtojnë në këtë rrugë."

Paragrafi 4, nënparagrafi (b)

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Në shtetet ku trafiku mban anën e majtë, rruga djathtas në kryqëzimet do të rregullohet me sinjale, shenja ose marketime rrugore."

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë pas paragrafit 7 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Asnjë parashikim i këtij neni do të merret sikur parandalon Palët Kontraktuese ose në divizionet e tyre nga shtrirja e rrugës në të djathtë, siç përmendet në paragrafin 2 të këtij neni për të gjithë përdoruesit e rrugës."

16. Shtesë në nenin 20 të Konventës

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Udhëtarët, kurdoherë që të jetë e mundur, do të shmangin rrugën e transportit; nëse ata do të bëjnë kështu me kujdes dhe ata nuk do të pengojnë pa nevojë ose ndërpresin trafikun."

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë pas paragrafit 2 të këtij neni

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Parashikimet e paragrafit 2 të këtij neni të Konventës pa përmendur personat handikapatë që udhëtojnë me karrige invalidësh, mundet në të gjitha rastet të përdorin rrugën e transportit."

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Udhëtarët që kalojnë në rrugën e transportit në përputhje me paragrafin 2, një paragraf shtesë të lexohet menjëherë pas paragrafit 2 dhe paragrafit 3 të këtij neni duhet të mbajnë sa më shumë të jetë e mundur qoshen e rrugës së transportit."

Paragrafi 5

Ky paragraf do të lexohet si vijon:

"a) Jashtë zonave të ndërtuara, udhëtarët që udhëtojnë në rrugën e transportit do të mbajnë anën e kundërt me atë të drejtimit të trafikut, me përjashtim kur ata veprojnë kështu vihen në rrezik ose në rrethana speciale. Megjithatë personat që shtyjnë një motor, një biçikletë, personat handikapatë që udhëtojnë me karrige invalidësh dhe grupe udhëtarësh që udhëhiqen nga një person i ngarkuar që të formojë një procesion, do të mbajnë anën e rrugës së transportit të përshtatshme për drejtimin e trafikut. Përveçse kur formojnë një procesion, udhëtarët që përdorin një rrugë transporti do të lëvizin në një radhë teke, nëse është e mundshme dhe nëse siguria e trafikut e kërkon kështu në mënyrë të veçantë kur shikimi është i dobët ose kur ka një trafik shumë të dendur automjesh."

b) "Parashikimet e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi mund të bëhen të zbatueshme në zonat e ndërtuara."

Paragrafi 6, nënparagrafi (c)

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Me qëllim të kalimit të rrugës së transportit në çdo vend si ai i kryqëzimeve për udhëtarët e pajisur me postera si të tilla ose të treguara me shenja në rrugën e transportit, udhëtarët nuk do të futen në rrugën e transportit pa u siguruar më parë që ata

mund të veprojnë kështu pa penguar trafikun e automjeteve. Udhëtarët do të kalojnë rrugën e transportit në një kënd të drejtë me akset e saj.”

17. Shtesë në nenin 21 të Konventës (Qëndrimi i shoferëve ndaj udhëtarëve)

Paragrafi 3

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Pa paragjykuar nenin 7 paragrafi 1 dhe nenin 1, paragrafin 1 të Konventës, nëse nuk ka në rrugën e transportit asnjë kryqëzim i shënjzuar me postera si e tillë ose i treguar me shenja në rrugën e transportit, shoferët që kthehen në një rrugë tjetër do të veprojnë kështu duke hapur rrugë, nëse është e nevojshme të stopojnë për këtë qëllim, për udhëtarët të cilët janë stepur në rrugën e transportit. Ato do të tregojnë vëmendje të veçantë për udhëtarët që kryqëzojnë rrugën e transportit për të hipur në një mjet të transportit publik ose pas zbritjes nga ai."

Paragrafi shtesë të vendoset në fund të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon:

- Kur në rrugët e rezervuara për udhëtarët, disa automjeteve u lejohet hyrja në rrethana të veçanta, legjislacioni kombëtar mund të nxjerrë rregulla që udhëheqin sjelljen e përdoruesve të rrugëve, në mënyrë që të shmangin çdo konflikt ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugëve dhe të vendosjes së një kufiri maksimal shpejtësie në mënyrë që shoferët të mund të stopojnë në kohë për të shmangur rrezikimin e udhëtarëve.

- Asnjë shofer nuk do të hyjë në një kryqëzim udhëtarësh pa sqaruar më parë se ai mund të mos jetë i detyruar të stopojë në të.

- Shoferët që futen në rrugë nga një zonë që e kufizon atë ose që lënë rrugën për në drejtim të një zone kufizuese do t'u hapin rrugën udhëtarëve."

18. Shtesë në nenin 23 të Konventës (Qëndrimi dhe parkimi)

Paragrafi 2, nënparagrafi (b)

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Automjetet, përveçse mjeteve me dy rrota, si dhe motorëve me dy rrota pa kosh, nuk do të parkohen anës një rruge transporti. Qëndrimi ose parkimi i automjeteve, përveçse kur e lejojnë ndryshe përmasat e zonës, do të vendosen paralel me qoshen e rrugës së transportit".

Paragrafi 3, nënparagrafi (a)

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Qëndrimi dhe parkimi i një mjeti do të jetë i ndaluar në rrugën e transportit:

- i) Brenda 5m përpara kryqëzimeve të udhëtarëve, në kryqëzimet e udhëtarëve, në kryqëzimet për çiklistët dhe në mbikalimet.

- ii) Në rrugët e tramvajit ose linjat hekurudhore në një rrugë ose pranë këtyre seksioneve, në mënyrë të tillë që lëvizja e tramvajit, trenave mund të pengohet."

Teksti shtesë të vendoset menjëherë pas pikës (ii) të këtij nënparagrafi.

Ky tekst do të lexohet si vijon: "Në afrimet të kryqëzimeve brenda 5 metrave të zgjatimit të anës pranë rrugës traversale dhe në kryqëzimet, përveçse kur tregohet ndryshe me shenja rrugore ose sinjale ose shenja rruge."

Paragrafi 3, nënparagrafi (c)(i)

Ky parashikim do të lexohet si vijon: "Brenda distancës së përshkruar nga legjislacioni kombëtar në afrimet e mbikalimeve dhe brenda 15 metrave në secilën anë autobusi, trolejbusi ose mjeti hekurudhor ndalon, përveçse kur legjislacioni kombëtar e parashikon ndryshe për një distancë të shkurtër".

Paragrafi 5

Ky paragraf do të lexohet si vijon:

"a) Çdo mjet që lëviz me motor, përveçse motorëve me dy krahë pa kosh dhe çdo trileri, dopio ose tek, kur janë stacionuar në rrugën e transportit jashtë zonave të banuara, do të sinjalizojnë për shoferët që afrohen në mënyrë të tillë që t'u japin atyre paralajmërimin e duhur për prezencën e tyre:

- i) Nëse shoferi është i detyruar të ndalojë automjetin e tij në një vendqëndrim të ndaluar, në përputhje me parashikimet e paragrafit 3(b)(i) ose (ii) të këtij neni të Konventës.

- ii) Nëse kushtet janë të tilla që shoferët të cilët afrohen nuk mundet ose mundet me vështirësi të lajmërohen në kohë për pengesën që mjeti përbën."

"b) Parashikimet e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi mund të bëhen të zbatueshme në zonat e ndërtuara."

"c) Rekomandohet për zbatimin e parashikimeve të këtij paragrafi, që legjislacioni kombëtar duhet ta parashikojë për t'u përdorur një nga pajisjet e referuara në aneksin 5, paragrafi 56 i Konventës."

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë në fund të këtij neni.

Ky paragraf të lexohet si vijon:

"a) Legjislacioni kombëtar mund të lejojë personat e paaftë brenda një lëvizje të kufizuar, të parkojnë mjetet e tyre në rrugët publike, kur koha e parkimit është e kufizuar."

"b) Shtetet mund t'u lëshojnë pesonave të paaftë me lëvizje të kufizuar një dokument që mban minimumi simbolin ndërkombëtar për të paaftët dhe emrin e mbajtësit. Ky dokument do t'i tregohet përkatësisht kur çdo person i tillë përdor lehtësirat e referuara në nënparagrafin (a) më sipër. Palët Kontraktuese do të njohin një dokument të tillë të lëshuar nga Pala tjetër Kontraktuese dhe lejojnë personat me dokumente të tilla të përdorin lehtësirat e referuara në nënparagrafin (a) më sipër."

19. Shtesë në nenin 25 të Konventës (Rrugët për motorë dhe rrugë të ngjashme)

Paragrafi 1

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Në rrugët për motorët dhe në afrime speciale ose rrugë dalje të marketuara me postera si rrugë motorike:

a) Përdorimi i rrugës do të ndalohet për udhëtarët, kafshët, çiklistët, karrocat, përveçse kur ato trajtohen si motorë dhe të gjitha mjetet e tjera, përveçse mjeteve motorike dhe trailerëve të tyre dhe mjeteve motorike ose mjeteve motorike me trailera kur ato janë të paafta, për arsye të projektit të tyre, të arritjes në rrugë të sheshta të shpejtësive specifike nga legjislacioni kombëtar, por të cilat nuk do të jenë më shumë se 40 km (25 milje) në orë.

b) Shoferëve do t'u ndalohet:

i) Që të kenë automjetet e tyre në qëndrim ose parkim kudoqoftë përveçse në vendet e shënuara si parkim; nëse mjeti është i detyruar të stopojë, shoferët e tyre do të përpiqen ta lëvizin atë nga rruga e transportit dhe gjithashtu të sinjalizojnë dhe nëse është e pamundur që të veprojnë në këtë mënyrë menjëherë të sinjalizojë prezencën e automjetit në një distancë që të paralajmërojë shoferët që afrohen në kohë; nëse një automjet për të cilin neni 23, paragrafi 5 i Konventës zbatohet është i përfshirë, rekomandohet që legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë për përdorim një nga pajisjet e referuara në aneksin 5, paragrafi 56 i Konventës.

ii) Për të bërë një lëvizje U për të lëvizur në drejtim të kundërt dhe për të ecur në rripin qëndror, duke përfshirë dhe nyjet kryqëzuese të dy rrugëve të transportit.

c) Procesionet, përdoruesit, garat me motorë dhe ngjarjet sportive me motorë, si dhe testet teknike të mjeteve dhe shasive prototip do të ndalohen si subjekt i parashikimeve që mund të parashikohen nga legjislacioni kombëtar."

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë pas paragrafit 1 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Kur një rrugë motorike përfshin më shumë se tri linja për të njëjtin drejtim të trafikut, shoferët e automjeteve të mallrave me tonazh mbi 3500 kg të lejueshme ose automjeteve të kombinuara me gjatësi më shumë se 7 m do të ndalohen që të marrin çdo linjë përveçse atyre dy linjave më të afërta me qoshen e rrugës përkatësisht në drejtim të trafikut."

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë pas paragrafit 3 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Automjeteve të rimorkiuara me mjete dhe pajisje zhvendosëse do t'u ndalohet hyrja në rrugën motorike, përveçse kur janë parashikuar përjashtime nga legjislacioni kombëtar. Automjetet e paafta të cilat janë në avari në një rrugë transporti dhe janë rimorkiuar nga mjetet rimorkiuese, do të lënë rrugën motorike në daljen më të afërt. Për qëllimet e këtyre rregullave pajisje rimorkiuese do të përfshijnë kavot, cimat etj."

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Për qëllimet e zbatimit të paragrafit të mëparshëm të këtij neni, rrugët e tjera të rezervuara për trafikun e mjeteve motorike, të cilat janë marketuar me postera si të tilla dhe që nuk mbështesin hyrjen për dhe nga pajisjet gjatazi, do të trajtohen si rrugë motorike."

20. Shtesë në nenin 20 të Konventës (Rregulla speciale të zbatueshme për çiklistët, motoçiklistët dhe karrocierët)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Do të ndalohet për çiklistët që të ecin pa mbajtur shufrat mbajtëse të paktën në një krah, për t'i lejuar vetes së tyre që të rimorkiohen nga një automjet tjetër, ose transportojë, rimorkiojë ose shtyjë objekte të cilat pengojnë ecjen e tyre ose rrezikojnë përdoruesit e tjerë të rrugëve. Parashikime të njëjta do të zbatohen për karrocierët dhe motoçiklistët në plotësim, karrocierët dhe motoçiklistët do të mbajnë shufrat në të dy krahët me përjashtim kur japin sinjalin e përshkruar në përputhje me Konventën."

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Karrocierët mund të autorizohen për të përdorur korsinë e çiklistëve dhe, nëse konsiderohet e këshillueshme, të lejohen nga përdorimi i pjesës tjetër të rrugës së transportit."

Paragrafi shtesë të vendoset në fund të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Veshja e helmetave mbrojtëse të miratuara është e detyrueshme për shoferët dhe pasagjerët e motoçikletave, përveçse kur janë garantuar përjashtimet nga legjislacioni kombëtar."

20 dy. Neni shtesë të vendoset menjëherë pas nenit 27 të Konventës.

Ky nen do të lexohet si vijon:

"Neni 27 dy"

Rregullat speciale të zbatueshme në zonat rezidenciale të shënuara me postera si të tilla

Në zonat rezidenciale të shënuara me postera si të tilla:

- a) udhëtarët mund të përdorin rrugën mbi të gjithë gjërësinë e saj. Lojërat janë të lejueshme;
- b) shoferët do të vazhdojnë me shpejtësi shumë të vogël, siç specifikohet nga legjislacioni kombëtar dhe e cila në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë 20 km (12 milje) në orë;
- c) shoferët nuk do të vendosin udhëtarët në rrezik dhe jo të sillen në një mënyrë penguese; nëse është e nevojshme ata duhet të stopojnë;
- d) udhëtarët nuk do të pengojnë trafikun e automjeteve pa nevojë;
- e) parkimi është i ndaluar me përjashtim kur lejohet me shenja parkimi;
- f) në kryqëzimet, përdoruesit e rrugëve që hyjnë nga një zonë rezidenciale do t'u hapin rrugën përdoruesve të tjerë të rrugës, me përjashtim kur është përjashtuar ndryshe nga legjislacioni kombëtar.

Neni 27 tre

Zonat e udhëtarëve

Legjislacioni kombëtar mund të parashikojë për zonat e udhëtarëve duke përfshirë një ose më shumë rrugë rezervë për trafikun e udhëtarëve dhe të specifikojë konditat për hyrje të veçanta të automjeteve.

Neni 27 katër

Rregulla speciale të zbatueshme për personat që bëjnë ndërtime dhe punë mirëmbajtje në rrugë

Personat që bëjnë ndërtime në rrugë ose punë mirëmbajtje do të veshin kominoshe fluorishente dhe reflektive që i bëjnë ata shumë të dukshëm gjatë ditës dhe natës."

21. Shtesë në nenin 29 të Konventës (Automjetet me shina)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Rregullat speciale që ndryshojnë nga ato të paraqitura në kapitullin II të Konventës mundet të adoptohen për lëvizjen e automjeteve me shina në rrugë. Megjithatë, rregulla të tilla mundet të mos jenë në konflikt me parashikimet e nenit 18 paragrafi 7 i Konventës."

Paragrafi shtesë të vendoset në fund të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Automjetet me shina në lëvizje ose në ndërrim në një korsi që shtrihet në rrugën e transportit do të parakalohet në anën më të përshtatshme në drejtim të trafikut. Nëse kalimi ose parakalimi nuk mund të kryhet në anën e duhur të drejtimit të trafikut për arsye të mungesës së vendit, këto manovra mund të realizohen në anën e kundërt, me kusht që mos të krijohet asnjë ndikim ose pengesë ndaj përdoruesve rrugorë të tjerë. Në rrugët me një kalim, automjetet me shina mund të parakalohen në anën e kundërt të asaj të duhur të drejtimit të trafikut, kur kërkesat e trafikut e garantojnë atë."

22. Shtesë në nenin 30 të Konventës (Ngarkesa e automjeteve)

Paragrafi 4

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Ngarkesat e projektuara përpara, prapa ose anash automjetit duhet të marketohen qartë në të gjitha rastet kur projektimi i tyre mund të mos dallohet nga shoferët e automjeteve të tjera; ndërmjet agimit dhe perëndimit, dhe gjithashtu në kohët e tjera kur shikimi është i papërshtatshëm, një dritë e bardhë dhe një pajisje reflektuese e bardhë do të përdoret për shenja të tilla përpara dhe një dritë e kuqe dhe një pajisje reflektuese e kuqe prapa automjetit. Më shumë detaje mbi automjetet me motor dhe trailerat e tyre:

a) Ngarkesat e projektuara më shumë se 1 m përpara ose prapa automjetit do të shënohen gjithmonë.

b) Ngarkesat e projektuara më shumë se 1 m prapa automjetit do të shënohen me një panel katror ose trekëndësh, me dimensionet e anëve minimumi 0.4 m, i fiksuar tek qoshja e jashtme e ngarkesës në mënyrë të tillë që të qëndrojë vazhdimisht në planin vertikal përpindikular me planin gjatësor të mesëm të automjetit ose me një pajisje tredimensionale (piramidale, prizmatike ose cilindrike) e varur nga fundi i ngarkesës dhe që ka sipërfaqe të përshtatshme ose projeksion. Paneli do të ketë rripa të kuq e të bardhë dhe pajisja tredimensionale rripa me ngjyrë të kuqe e të bardhë dhe anët me ngjyrë të lehtë. Pjesët me ngjyrë të kuqe e të bardhë do të pajisen me reflektor ose me një bojatisje retro-reflektive. Pika më e lartë e sipërfaqes së ndriçuar ose reflektuar të pajisjes së përmendur më sipër nuk do të jetë më e madhe se 12.6 m mbi nivelin e tabanit. Pika më e ulët nuk do të jetë më pak se 0.4 m mbi nivelin e tabanit.

c) Në rastet e transportit rastësor në distanca të shkurtra legjislacioni kombëtar mund të parashikojë për shenja më të thjeshta".

23. Fshirë

24. Shtesë në nenin 31 të Konventës (Sjellja në rastet e aksidenteve)

Paragrafi 1

Nënparagrafi shtesë të vendoset në fund të këtij paragrafi.

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Nëse aksidenti ka shkaktuar vetëm dëme materiale dhe nëse çdo pjesë që ka pësuar dëmtim nuk është prezent, personi i përfshirë në aksident duhet sa të jetë e mundur të japë emrat e tyre dhe adresat në spot dhe do t'ia japë në çdo rast këtë informacion palës që ka pësuar dëmin sa më shpejt të jetë e mundur me kanalin e duhur ose, nëse nuk mundet kështu, nëpërmjet policisë".

25. Fshirë

26. Shtesë në nenin 34 të Konventës (Përjashtimet)

Paragrafi 2

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Shoferët e automjeteve prioritare, kur paralajmërimi i lëvizjes së tyre është dhënë nga pajisje speciale të automjetit dhe me kusht që ata nuk do të rrezikojnë përdoruesit e tjerë të rrugës, nuk do të veprojnë në përputhje me të gjitha ose ndonjë parashikim të kapitullit II të Konventës, siç mund të jetë modifikuar nga kjo Marrëveshje, përveçse nga ato të nenit 6 të saj, paragrafi 2. Shoferët e automjeteve të tilla do të operojnë pajisjet

paralajmëruese të tilla, vetëm kur urgjenca e udhëtimit të tyre e kërkon këtë."

27. Shtesë në nenin 44 të Konventës (Konditat për pranimin e motorëve në trafikun ndërkombëtar)

Paragrafi 1

Nënparagrafi shtesë të vendoset në fund të këtij paragrafi.

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Në anët: Të pajisura me reflektorë me ngjyrë qelibari të fiksuar në krahët e sponteve ose me pajisje reflektive që tregojnë një rreth të vazhdueshëm.

Paragrafi 2, nënparagrafi 1

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "(d) pajisur me reflektor të kuq prapa, dhe një llampë që tregon një dritë të verdhë e të bardhë përpara dhe një llampë të kuqe të lehtë prapa."

Nënparagrafi shtesë të vendoset menjëherë në fund të paragrafit 2.

Ky nënparagraf do të lexohet si vijon: "Pajisur me shenja anësore që konsistojnë ose në reflektor qelibar ose me pajisje retro-reflektive që tregojnë një rreth të vazhdueshëm."

28. Shtesë në aneksin 1 të Konventës (Përjashtimet në detyrimet për pranimin e automjeteve me motor dhe trailerave në trafikun ndërkombëtar)

Paragrafi shtesë të vendoset menjëherë pas paragrafit 7 të këtij neni.

Ky paragraf do të lexohet si vijon: "Palët Kontraktuese mund të kenë kushtet për pranimin në territoret e tyre të trafikut ndërkombëtar për çdo automjet motorik që kanë një masë të lejueshme maksimale mbi 3500 kg që automjetet duhet të kenë zinxhirët e borës ose pajisje të tjera efektive në mjet gjatë kushteve dimërore të kohës."

L I G J

Nr.9191, datë 19.2.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË FINANCIMIT TË PROJEKTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT TË ZHVILLIMIT SHQIPTAR, SI AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT DHE KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU (KfW) PËR PROJEKTIN "FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE-III"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e financimit të projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit të Zhvillimit Shqiptar, si agjenci e zbatimit të projektit dhe Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) për projektin "Fondi i investimeve sociale-III".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4170, datë 15.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

FINANCIMI DHE PROJEKTI NDËRMJET KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (HUAMARRËSI) DHE FONDI I ZHVILLIMIT SHQIPTAR (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 2.300.813,47 EURO SI HUA DHE 255.645,94 EURO SI KONTRIBUT FINANCIAR

FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE III –

Në bazë të marrëveshjes së datës 22 shtator 2003 për t'u përfunduar ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunim financiar (marrëveshje qeveritare), Huamarrësi, Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW hyjnë në Marrëveshjen e huasë, financimit dhe projektit si më poshtë:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë dhe i kontributit financiar

1.1 KfW do t'i japë Huamarrësit një hua jo më shumë se 23 00 813,47 euro dhe një kontribut financiar jo më shumë se 255 645, 94 euro.

Kontributi financiar nuk do të jetë i kthyeshëm në rast se nuk kushtëzohet ndryshe në nenin 5.3.

1.2 Huamarrësi do të kanalizojë të gjithë huanë dhe kontributin financiar për Agjencinë e zbatimit të projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit do ta përdorë huanë për të bashkëfinancuar kostot e rehabilitimit të projekteve të vogla të infrastrukturës ekonomike dhe sociale dhe njësitë që gjenerojnë punësim në Shqipërinë Veriore dhe Verilindore. Agjencia e zbatimit të projektit do të përdorë kontributin financiar për të mbështetur FZSHH-në me programe koordinimi dhe kontrolli, me aplikimin e MIS dhe analiza impakti kryesisht në fushat e nxitjes së punësimit dhe parandalimit të konfliktit. Të dyja së bashku, huaja dhe kontributi financiar do të përdoren së pari për të paguar kostot e shkëmbimit të monedhës së huaj. Të dyja së bashku përbëjnë projektin. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e projektit dhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksat dhe detyrime të tjera publike që do të lindin nga Huamarrësi ose Agjencia e zbatimit të projektit dhe taksat e importit nuk do të financohen nga huaja ose nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i huasë dhe i kontributit financiar tek Agjencia e zbatimit të projektit

2.1 Huamarrësi do ta drejtojë huanë dhe kontributin financiar tek Agjencia e zbatimit të projektit si një kontribut financiar të pakthyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë.

2.2 Para disbursimit të parë nga huaja dhe kontributi financiar, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një kopje të marrëveshjes të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huasë dhe i kontributit financiar nuk përbën ndonjë detyrim të Agjencisë së zbatimit të projektit ndaj KfW-së për detyrime pagesash sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimet

3.1 KfW-ja do të disbursojë huanë dhe kontributin financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesën e Agjencisë së zbatimit të projektit. Me një marrëveshje të veçantë, Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja do të bien dakord mbi procedurat e disbursimit, në veçanti mbi evidencën që provon se shumata e kërkuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

3.2 KfW-ja do të ketë të drejtën të refuzojë bërjen e disbursimeve pas 31 dhjetorit 2007.

Neni 4

Tarifa e angazhimit, interesi dhe shlyerja

4.1 Huamarrësi duhet të paguajë një tarifë angazhimi prej $\frac{1}{4}\%$ në vit mbi shumat e huasë së padisbursuar. Ky detyrim angazhimi do të llogaritet për një periudhë duke filluar tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe duke përfunduar në datën në të cilën janë debituar disbursimet.

4.2 Huamarrësi do të paguajë interesin mbi kredinë në shkallën prej 0.75% në vit. Interesi do të ngarkohet që nga datat në të cilat janë debituar disbursimet deri në datat në të cilat janë kredituar shlyerjet në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë detyrimin e angazhimit, interesin dhe ndonjë interes mbi shumat e papaguara në bazë gjashtëmujore sipas nenit 4.5 me 30 qershor për gjashtë mujorin e I dhe 30 dhjetor për gjashtëmujorin e II. Pagesa e parë e detyrimit të angazhimit do të paguhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Marrësi do të shlyejë kredinë si më poshtë:

Këstet	Data			Shuma
1	30 qershor	2014	euro	38.000,00
2	30 dhjetor	2014	euro	38.000,00
3	30 qershor	2015	euro	38.000,00
4	30 dhjetor	2015	euro	38.000,00
5	30 qershor	2016	euro	38.000,00
6	30 dhjetor	2016	euro	38.000,00
7	30 qershor	2017	euro	38.000,00
8	30 dhjetor	2017	euro	38.000,00
9	30 qershor	2018	euro	38.000,00
10	30 dhjetor	2018	euro	38.000,00
11	30 qershor	2019	euro	38.000,00
12	30 dhjetor	2019	euro	38.000,00
13	30 qershor	2020	euro	38.000,00
14	30 dhjetor	2020	euro	38.000,00
15	30 qershor	2021	euro	38.000,00
16	30 dhjetor	2021	euro	38.000,00
17	30 qershor	2022	euro	38.000,00
18	30 dhjetor	2022	euro	38.000,00
19	30 qershor	2023	euro	38.000,00
20	30 dhjetor	2023	euro	38.000,00
21	30 qershor	2024	euro	38.000,00
22	30 dhjetor	2024	euro	38.000,00
23	30 qershor	2025	euro	38.000,00
24	30 dhjetor	2025	euro	38.000,00
25	30 qershor	2026	euro	38.000,00
26	30 dhjetor	2026	euro	38.000,00
27	30 qershor	2027	euro	38.000,00
28	30 dhjetor	2027	euro	38.000,00
29	30 qershor	2028	euro	38.000,00
30	30 dhjetor	2028	euro	38.000,00
31	30 qershor	2029	euro	38.000,00
32	30 dhjetor	2029	euro	38.000,00

33	30 qershor	2030	euro	38.000,00
34	30 dhjetor	2030	euro	38.000,00
35	30 qershor	2031	euro	38.000,00
36	30 dhjetor	2031	euro	38.000,00
37	30 qershor	2032	euro	38.000,00
38	30 dhjetor	2032	euro	38.000,00
39	30 qershor	2033	euro	38.000,00
40	30 dhjetor	2033	euro	38.000,00
41	30 qershor	2034	euro	39.000,00
42	30 dhjetor	2034	euro	39.000,00
43	30 qershor	2035	euro	39.000,00
44	30 dhjetor	2035	euro	39.000,00
45	30 qershor	2036	euro	39.000,00
46	30 dhjetor	2036	euro	39.000,00
47	30 qershor	2037	euro	39.000,00
48	30 dhjetor	2037	euro	39.000,00
49	30 qershor	2038	euro	39.000,00
50	30 dhjetor	2038	euro	39.000,00
51	30 qershor	2039	euro	39.000,00
52	30 dhjetor	2039	euro	39.000,00
53	30 qershor	2040	euro	39.000,00
54	30 dhjetor	2040	euro	39.000,00
55	30 qershor	2041	euro	39.000,00
56	30 dhjetor	2041	euro	39.000,00
57	30 qershor	2042	euro	39.000,00
58	30 dhjetor	2042	euro	39.000,00
59	30 qershor	2043	euro	39.000,00
60	30 dhjetor	2043	euro	39.813,47
TOTAL			EURO	2 300 813,47

4.5 Nëse ndonjë nga këstet e shlyerjes nuk është në dispozicion të KfW-së në kohën e duhur, KfW-ja mund të rrisë normën e interesit të pagesave të vonuara në përqindjen bazë, plus 3 % në vit për një periudhë, duke filluar nga data e caktuar dhe përfunduar në datën në të cilën janë kredituar këto shlyerje në llogarinë e KfW-së specifikuar në nenin 4.9. “Përqindja bazë” është përqindja e interesit të caktuar nga Deutsche Bundesbank, si përqindje bazë në përqindjen e aplikueshme në datën përkatëse. Në rastin e interesave të vonuara, KfW-ja mund të kërkojë dëmshpërblim. Ky dëmshpërblim nuk mund të kalojë shumën e mbërritur, nëse interesi është caktuar mbi këtë interes të prapambetur, në përqindjen bazë të mbetur në datën e caktuar plus 3% në vit.

4.6 Detyrimi i angazhimit, interesi dhe ndonjë detyrim i prapambetur sipas nenit 4.5 do të llogaritet bazuar në vitin me 360 ditë dhe në muajt me 30 ditë.

4.7 Shuma e huasë së shlyer para kohe ose e padisbursuar duhet të kreditohet në sasi të barabarta përkundrejt të gjitha kësteve të shlyerjeve të papaguara derisa KfW-ja me dëshirën e saj të caktojë një metodë të ndryshme shlyerje në një rast të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave për volume më të pakta.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas zgjedhjes së saj, pagesat e marra kundrejt pagesave për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të kredisë të konkluduara midis KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do të dërgojë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së nr. 22560801 në Kreditanstalt für Wiederaufbau Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, S.W.I. F.T.; KFWIDEFF), nuk lejohet asnjë kundërkërkesë kundrejt pagesave të tilla.

Neni 5

Ndërprerja e disbursimeve dhe e shlyerjeve parakohe

5.1 Huamarrësi në çdo kohë:

a) në varësi të realizimit të detyrimeve të tij sipas nenit 8 mund të anulojë çdo shumë huaje të padisbursuar akoma;

b) mund të shlyejë huanë të gjithën ose në pjesë para maturimit.

5.2 KfW-ja nuk mund të ndërpresë disbursimet përveçse kur:

a) Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat në kohën e duhur;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që lidhen me këtë Marrëveshje janë shkelur;

c) Agjencia e zbatimit të projektit është e paaftë të provojë që huaja ose kontributi financiar është përdorur për qëllimin e caktuar;

d) janë krijuar rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, veprimin ose qëllimin e projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës së pretenduar nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Në qoftë se ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a), b) ose c) ka ndodhur dhe nuk është shmangur brenda një periudhe të caktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë së paku 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 a), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të papaguara të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit që rrjedh dhe të gjitha detyrimeve të tjera të rastësishme;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të kontributit financiar dhe të të gjitha shumave të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit që rrjedh dhe të gjitha detyrimeve të tjera të rastësishme;

c) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të tilla pasi Agjencia e zbatimit të projektit është e paaftë të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 6

Kostot dhe shpenzimet publike

6.1 Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat që do të bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje pa ndonjë zbritje për taksat, detyrime të tjera publike ose kosto të tjera dhe do të paguajë kostot e transferimit dhe shkëmbimit që ndodhin në lidhje me disbursimet e kredisë dhe kontributit financiar.

6.2 Huamarrësi do të përballojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që veprojnë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Fuqia ligjore e kësaj Marrëveshjeje dhe përfaqësimi

7.1 Në kohën e duhur, para disbursimit të parë, Huamarrësi do të pajisë KfW-në me një evidencë të pranueshme për KfW-në, që vërteton se Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjeve të tij konstitucionale dhe ligjeve të tjera për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

7.2 Ministri i Financave dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe autorizuar me specimen të firmave të mirëfillta nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit të Zhvillimit Shqiptar dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe autorizuar me specimen të firmave të mirëfillta nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Agjencinë e zbatimit të projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Fuqia e përfaqësimit nuk do të përfundojë deri në kohën që shprehja e revokimit nga përfaqësuesi i autorizuar është marrë nga KfW-ja.

7.3 Amendamente ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë shënim ose deklaratë nga palët kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo shënim ose deklaratë e tillë do të merret sapo të arrijë në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në adresën tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW:
Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 111141
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Telefax: +49-(0)69-74 31-29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Republika e Shqipërisë.
Telefax: +355-42-28494

Për agjencinë e zbatimit Fondi i Zhvillimit Shqiptar të projektit:
Rr. Durrësit, Instituti i Tokave
Laparakë/Tiranë
Republika e Shqipërisë.
Telefax: + 355-42-34885

7.4 Ndryshimet në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore midis KfW-së dhe Huamarrësit, nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë së zbatimit të projektit.

Neni 8 Projekti

8.1 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) do të përgatisë, do të zbatojë, do të operojë dhe do të mirëmbajë projektin në përputhje me praktika inxhinierike dhe financiare të qëndrueshme dhe thellësisht në përputhje me konceptimin e projektit, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) do të japë kontrata për:

- pajisje materiale që do të financohen nga kredia dhe që i kalon 5 000 000 \$ pas një tenderi ndërkombëtar;

- punime civile që do të financohen nga huaja dhe që i kalojnë 5 000 000 \$ pas një tenderi konkurrues të kufizuar për firmat që veprojnë në Shqipëri;

- mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja me një vlerë kontrate deri në 5 000 000 \$ sipas vlerësimit paraprak të çmimeve;

- shërbime konsulence që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar pas një tenderi konkurrues ndërkombëtar;

c) do të mirëmbajë ose do të kërkojë të mirëmbahen librat dhe shënimet, duke treguar pa mëdyshje të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe duke identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet financuar nga kjo hua/kontribut financiar;

d) do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të kontrollojnë librat dhe shënimet, si dhe çdo ose të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me zbatimin e projektit dhe të vizitojë projektin dhe të gjitha instalimet lidhur me të;

e) do të pajisë KfW-në me çdo ose të gjitha informacionet dhe relacionet mbi Projektin dhe progresin e tij në vazhdim, siç mund të kërkohej nga KfW.

8.2 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë që i referohen nenit 8.1 në një marrëveshje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia e zbatimit të projektit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, sipas kërkesës, të pajisin KfW-në me evidencën që provon se kostot e papaguara nga kjo Hua/kontribut financiar janë mbuluar;

b) sipas Marrëveshjes së tyre do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo ose të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e zbatimit të projektit në përputhje me praktika të qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve nga Agjencia e zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, t'i japë Agjencisë së zbatimit të Projektit ndonjë dhe të gjitha lejet e domosdoshme për zbatimin e projektit.

8.5 Për transportin e mallrave që do financohen nga huaja/kontributi financiar do të zbatohen dispozitat e marrëveshjes qeveritare, të cilat janë të njohura për marrësin.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi dhe Agjencia e zbatimit të projektit duhet të garantojë që personat, të cilët janë ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e kontratës për pajisje dhe shërbime për t'u financuar dhe me kërkimin e disbursimeve të shumave të huasë/kontributit financiar, nuk do të kërkojnë, pretendojnë, japin, premtojnë ose t'u premtohen pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera nuk do të influencohen nga kjo. Çdo boshllëk që do të rezultojë nga kjo, do të plotësohet nga një dispozitë e përshtatshme me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe Agjencia e zbatimit të projektit nuk duhet të nënshkruajnë ose transferojnë garanci ose hipotekim që ndonjë mund të pretendojë nga kjo Marrëveshjeje.

9.4 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përfundimit do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do t'i referohet tekstit gjermanisht.

9.5 Kjo hua dhe Marrëveshje projekti dhe financimi nuk do të hyjë në fuqi deri sa të hyjë në fuqi Marrëveshja qeveritare në të cilën ajo është bazuar.

Shkruar në gjashtë kopje origjinale, tri në gjermanisht dhe tri në anglisht.

Frankfurt am Main, _____

Tiranë, më 14 tetor 2003

KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga

MINISTRIA E FINANCAVE

FONDI ZHVILLIMIT SHQIPTAR

Neni i arbitrazhit

Të gjitha kushtet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje dhe të gjitha polemikat mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe të nenit të arbitrazhit, që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve kontraktuese, duhet të paraqiten në seancat e arbitrazhit siç është rënë dakord në Marrëveshjen tripalëshe të arbitrazhit lidhur me kredinë, Marrëveshjen e projektit dhe financimit të datës 5 tetor 2002 (Fondi i investimeve sociale-II). Vlefshmëria e Marrëveshjes në fjalë të arbitrazhit duhet të shtyhet derisa të kryhen plotësisht të gjitha detyrimepagesat.

L I G J
Nr.9192, datë 19.2.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË MBI BASHKËPUNIMIN USHTARAK”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë mbi bashkëpunimin ushtarak”, nënshkruar në Bukuresht më 19 nëntor 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4171, datë 15.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË
MBI BASHKËPUNIMIN USHTARAK

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, tani e në vazhdim do të quhen “Palët”.

Duke e konsideruar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes si një element të rëndësishëm dhe përmirësimin e sistemit të sigurisë në Europë dhe rajon;

duke njohur rolin themelor të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, NATO-s në sigurimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare;

duke pasur si qëllim zhvillimin e marrëdhënieve dhe thellimin e mirëkuptimit reciprok ndërmjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Rumanisë,
palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Palë dërguese” do të kuptojmë Palën që delegon përfaqësuesit e saj në territorin e shtetit të Palës tjetër, në përputhje me kompetencat e saj.

b) “Palë pritëse” do të kuptojmë Palën e cila pranon në territorin e shtetit të saj, përfaqësuesit e deleguar të Palës tjetër.

c) “Vend i përcaktuar më parë” do të thotë një vend i përcaktuar në territorin e shtetit të Palës pritëse ku do të mbërrijë një delegacion i Palës dërguese.

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë brenda kompetencave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar respektiv, në bazë të parimeve të barazisë dhe përfitimit reciprok.

Neni 3

Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve specifike për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të kryhet nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë.

Neni 4

1. Palët do të bashkëpunojnë në këto fusha:
 - a) politika e mbrojtjes dhe planifikimi i mbrojtjes;
 - b) strategji ushtarake dhe doktrina;
 - c) pjesëmarrje në aktivitetet e programit të “Partneritetit për paqe”, misione paqeruajtëse dhe ato humanitare, si dhe operacione të tjera brenda organizmave ndërkombëtarë;
 - d) punë kërkimore, shkencore dhe zhvillimi në fushën e teknologjisë ushtarake;
 - e) standardizimin e meterologjisë ushtarake;
 - f) topografi dhe studime tokësore;
 - g) kartografi dhe hidrografi;
 - h) shkëmbim informacionesh, dokumentacionesh në fushën e legjislacionit ushtarak;
 - i) histori ushtarake dhe arkivat;
 - j) aktivitete kulturore dhe sportive;
 - k) asistencë në fushën shëndetësore;
 - l) marrëdhënie me publikun;
 - m) fusha të tjera.
2. Bashkëpunimi në fushat e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni mund të rregullohet me protokolle shtesë të Marrëveshjes aktuale.

Neni 5

- Bashkëpunimi do të realizohet në këto forma:
- a) vizita zyrtare dhe mbledhje pune;
 - b) konsultime, konferenca dhe seminare;
 - c) studime dhe trajnime në akademitë ushtarake dhe institucione ushtarake për kërkim dhe zhvillim, shkëmbim të pedagogëve dhe trajnuesve në fusha të ndryshme;
 - d) pjesëmarrje e vëzhguesve në stërvitje ushtarake;
 - e) vizita në njësi, institucione dhe muzeume ushtarake;
 - f) aktivitete kulturore dhe sportive.

Neni 6

1. Bazat e bashkëpunimit janë miratuar sipas një plani vjetor bashkëpunimi ndërmjet ministrive të mbrojtjes të Palëve.
2. Ministrinë e mbrojtjes të Palëve do të bëjnë propozime për planin e bashkëpunimit të paraqitur në paragrafin 1 të këtij neni, deri në datën 15 tetor të vitit në vazhdim.
3. Planin e bashkëpunimit vjetor do të nënshkruhet nga autoritetet përfaqësuese të ministrive të mbrojtjes deri më 15 dhjetor të vitit në vazhdim.
4. Planin vjetor të bashkëpunimit përmban informacion lidhur me titullin e aktivitetit, kohën dhe vendimin e zbatimit, si dhe numrin e pjesëmarrësve.

Neni 7

1. Shpenzimet për aktivitetet e planit vjetor të bashkëpunimit do të kryhen mbi bazat e reciprocitetit.
2. Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet për:
 - a) transportimin vajtje-ardhje në vendin e përcaktuar më parë;
 - b) dietat për periudhën e qëndrimit;
 - c) dokumentet e kërkuara nga autoritetet e shtetit të Palës pritëse për hyrjen dhe daljen në territorin e tij.
3. Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet për:
 - a) transportin e tyre në territorin e shtetit të tij;
 - b) ushqimin;
 - c) akomodimin.
4. Në raste emergjence, Pala pritëse do të ofrojë asistencë mjekësore dhe trajtim bazë dentar në institucionet mjekësore ushtarake. Pacienti do të kthehet në vendin e tij me shpenzimet e Palës dërguese në rast se nevojitet trajtim i mëtejshëm mjekësor.

Neni 8

1. Kompensimi i dëmeve të shkaktuara në territorin e Palës pritëse, nga personeli i Palës dërguese gjatë kryerjes së detyrave të tyre, stërvitjes ose në lidhje me to, do të llogaritet sipas legjislacionit në fuqi të shtetit të Palës pritëse.
2. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në rastet e dëmtimeve të bëra ekskluzivisht në pajisjet dhe mjediset ushtarake, do të zgjidhet në mënyrë miqësore pa iu drejtuar autoriteteve gjyqësore kombëtare ose ndërkombëtare. Në rastet kur një mosmarrëveshje e tillë nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Rregullat për mbulimin e shpenzimeve, përveç atyre të përmendura në nenin 7 dhe 8, do të përcaktohen në protokollin shtesë të Marrëveshjes aktuale.

Neni 10

1. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen deri në hyrjen në fuqi të marrëveshjes bilaterale të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve.
2. Palët angazhohen në përdorimin, trajtimin dhe mbrojtjen e materialeve dhe informacioneve të klasifikuara, të cilat ato i përdorin në kuadrin e Marrëveshjes aktuale dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare të palëve për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.
3. Secila Palë ofron ndaj informacionit të klasifikuar nga Pala tjetër të njëjtën mbrojtje siç bën me informacionin e vet të klasifikuar të nivelit ekuivalent të klasifikimit.
4. Materiali dhe informacioni i klasifikuar transmetohet vetëm përmes kanalesh zyrtare përmes autoriteteve kompetente të Palëve.
5. Çdo material apo informacion i klasifikuar që merret për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes aktuale nuk mund t'u jepet palëve të treta në mënyrë direkte, pa miratimin me shkrim të palës së origjinës.

Neni 11

Dispozitat e Marrëveshjes aktuale nuk ndikojnë mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare ku ato janë palë.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes aktuale, do të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve dhe pa iu drejtuar gjykatës ndërkombëtare ose palëve të treta.

Neni 13

1. Marrëveshja aktuale do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga palët, ku ato konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi.

2. Marrëveshja aktuale do të jetë në fuqi për një periudhë kohore të papërcaktuar. Marrëveshja mund të denoncohet nga secila Palë, në çdo kohë, me shkrim. Kjo Marrëveshje përfundon 6 muaj pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër.

3. Marrëveshja aktuale mund të përmirësohet në çdo kohë me shkrim me miratimin e Palëve. Përmirësimet hyjnë në fuqi sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni.

4. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të përfundojë “Marrëveshja, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë, për bashkëpunimin në fushën ushtarake”, e nënshkruar në Bukuresht më 7 tetor 1992.

Nënshkruar në Bukuresht më, 19 nëntor 2003 në gjuhën shqipe, rumune dhe angleze, secila në dy kopje origjinale ku të gjitha tekstet janë të barabarta autentike. Në rast dallimesh në përkthim, do të paraprijë teksti anglisht.

L I G J

Nr.9193, datë 19.2.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë”, nënshkruar në Kostur më 10 nëntor 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4172, datë 15.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Greqisë tani e në vazhdim të quajtura “Palë”:

në kuadrin e bashkëpunimit ekzistues të përgjithshëm ndërmjet Palëve dhe në paralelizëm me zhvillimet e rëndësishme të projekteve në Shqipëri të ndërmarrë nga Pala greke, Palët me anë të kësaj Marrëveshjeje, janë të gatshme të zgjerojnë bashkëpunimin e sipërpërmendur;

duke pasur parasysh objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, veçanërisht parimet për ndalimin e përdorimit të forcës ose të kërcënimit për përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe respektimin e sovranitetit, moscenimit të kufijve, integritetit territorial, mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve;

duke ndjekur qëllimet e “Dokumentit të partneritetit për paqe” të adoptuar në Samitin e Brukselit më 1994;

duke respektuar angazhimet e marra në zbatim të Aktit Final të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Europë (1975), Kartën e Parisit për Europën e Re (1990) dhe Dokumentin e Vjenës mbi masat e ndërtimit të besimit dhe sigurisë (1999), si dhe dokumenteve të tjera të OSBE-së;

duke marrë në konsideratë Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë, nënshkruar në Tiranë, më 21 mars 1996;

duke vënë theksin mbi nevojën për të zhvilluar bashkëpunim të gjithanshëm duke përfshirë rritjen e saj të mëtejshme në fushën e mbrojtjes, meqenëse Republika e Greqisë është anëtare e NATO-s dhe mbështetet përpjekjet e Republikës së Shqipërisë për t’u bashkuar në NATO dhe strukturat europiane;

me dëshirën për të nxitur më tej bashkëpunimin dy palësh në fushën e mbrojtjes, ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është vendosja e kuadrit ligjor dhe e drejtimeve kryesore të bashkëpunimit ndërmjet Palëve në fushën e mbrojtjes, brenda limiteve të kompetencave të tyre të siguruar nga legjislacioni i tyre kombëtar, në përputhje me parimet e barazisë dhe të përfitimit reciprok.

Neni 2

Parime të përgjithshme

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera dypalëshe ose shumëpalëshe dhe as të drejtën e Palëve për të nënshkruar marrëveshje të ngjashme me palë të treta. Kjo Marrëveshje nuk është e drejtuar kundër ndonjë shteti apo grup shtetesh.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet palëve duhet të mbulojë fushat dhe drejtimitet e mëposhtme:

- shkëmbim pikëpamjesh në politikën e mbrojtjes dhe sigurimit;
- çështje të armatimit dhe teknologjisë së mbrojtjes;
- arsimim ushtarak dhe trajnim të personelit të specializuar;
- mbështetje logjistike;
- aktivitete në kuadrin e partneritetit për paqe;

- sektorët ushtarakë të armëkontrollit dhe çarmatimit;
- operacionet e mbështetjes së paqes;
- menaxhimin e krizave;
- informacion ushtarak;
- mjekësisë ushtarake;
- xhenios;
- legjislacioni ushtarak;
- kërkimet shkencore në fushën e mbrojtjes (teorike dhe të aplikuara).

Aktivitetet e përmendura më lart mund të zgjerohen ose të kufizohen dhe fusha të tjera bashkëpunimi mund të shtohen nëse Palët bien dakord.

Neni 4

Format e bashkëpunimit

Ky bashkëpunim ndërmjet Palëve mund të përfshijë format e mëposhtme:

- Vizita zyrtare dhe takime të rregullta në nivelin e ministrave të mbrojtjes, zëvendësve të tyre, shefave të shtabeve të përgjithshme ose përfaqësuesve të tjerë të Palëve.
- Pjesëmarrje në stërvitjet ushtarake dhe ekspozitat e pajisjeve ushtarake.
- Pjesëmarrje në veprimtaritë zyrtare, kulturore dhe të llojeve të tjera të organizuara nga Palët.

Neni 5

Planizimi i bashkëpunimit

Me qëllim që të përmbushen parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të zhvillojnë, në baza vjetore, programin e bashkëpunimit për vitin pasardhës. Për të përcaktuar programin, Palët do të shkëmbejnë propozimet në formën e kërkesave. Propozimet do të dërgohen në departamentet përkatëse të Palëve deri në 15 qershor, çdo vit.

Programi i bashkëpunimit do të përmbajë:

- përshkrimin e aktiviteteve;
- numrin e pjesëmarrësve;
- kohëzgjatjen, vendin dhe kohën për çdo aktivitet;
- informacione të tjera të nevojshme.

Plani vjetor i bashkëpunimit miratohet dhe firmoset nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve më 1 dhjetor të vitit paraardhës me vitin për të cilin është përgatitur plani.

Neni 6

Çështjet financiare

Palët do të përgjigjen për shpenzimet e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në programin e bashkëpunimit në baza reciprociteti.

Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet si më poshtë:

- shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje në territorin e Palës pritëse;
- shpenzimet që lidhen me pritjen, parkimin, sigurinë dhe furnizimin me karburant të avionëve ushtarakë që bëjnë transportin e delegacioneve për në vendin pritës dhe anasjelltas;
- shpenzimet që lidhen me transportin e një personi të sëmurë/plagosur për në vendin e tij/saj.

Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet si më poshtë:

- transportin e brendshëm të delegacionit nga pika e mbërritjes deri në rajonin ku do të zhvillohet aktiviteti i planifikuar, si dhe shpenzimet për akomodim, ushqim dhe aktivitetet kulturore që do të organizohen;
- shërbimin e plotë mjekësor duke përfshirë edhe shtrimin në spital në raste emergjencash;
- shpenzimet që lidhen me trajnimin në aktivitete specifike për të cilat Palët kanë rënë dakord më përpara.

Neni 7
Çështjet ligjore

Dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet shteteve të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, lidhur me statusin e forcave të tyre dhe protokollin e parë shtesë, nënshkruar në Bruksel më 19 qershor 1995, do të jenë të zbatueshme rast pas rasti në këtë Marrëveshje.

Neni 8
Ruajtja e informacionit të klasifikuar

Palët angazhohen në përdorimin, trajtimin dhe mbrojtjen e materialeve dhe informacioneve të klasifikuara, në të cilat ato mund të kenë akses në kuadrin e Marrëveshjes aktuale, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare të palëve për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Secila Palë ofron ndaj informacionit të klasifikuar nga Pala tjetër të njëjtën mbrojtje si për informacionin e vet të klasifikuar të nivelit ekuivalent të klasifikimit. Materiali dhe informacioni i klasifikuar transmetohet vetëm përmes kanalesh zyrtare përmes autoriteteve kompetente të Palëve. Çdo material ose informacion i klasifikuar që merret për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes aktuale, nuk mund t'u jepet palëve të treta në mënyrë direkte, pa miratimin me shkrim të Palës së origjinës.

Neni 9
Rregullime plotësuese

Në mënyrë që të zbatohen qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, Palët mund të arrijnë në marrëveshje specifike.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve dhe pa iu drejtuar gjykatës ndërkombëtare ose palëve të treta.

Neni 11
Amendamentet

Secila Palë mund të propozojë me shkrim amendamente për çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje. Pasi të bihet dakord nga Palët, amendamentet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 12.

Neni 12
Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit ku Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi. Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë (5) pesëvjeçare, pas kësaj ajo mund të rinovohet automatikisht dhe për një periudhë tjetër (5) pesëvjeçare në rast se asnjëra nga Palët nuk e ka njoftuar Palën tjetër deri 6 muaj para përfundimit të Marrëveshjes aktuale, se ajo synon ta përfundojë Marrëveshjen aktuale. Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim për Palën tjetër. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje përfundon 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit për denoncimin e saj.

Në rast se ka çështje apo ankesa financiare që mbeten të pazgjidhura, në kohën e denoncimit apo përfundimit, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që lidhen me ato çështje apo ankesa, do të mbeten në fuqi derisa ato të jenë zgjidhur përfundimisht.

Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, marrëveshja për bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë nënshkruar më 7 nëntor 1992, shfuqizohet.

Nënshkruar në Kostur më, 10 nëntor 2003 në gjuhën shqipe, greke dhe angleze, secila në dy kopje origjinale ku të gjitha tekstet janë autentike të barabarta. Në rast mosmarrëveshje në interpretimin, do të merret për bazë teksti në anglisht.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministri i Mbrojtjes
Pandeli Majko

Për Qeverinë e Republikës së Greqisë
Ministri i Mbrojtjes Kombëtare
Yannos Papantoniou

L I G J
Nr.9194, datë 19.2.2004

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8671, DATË 26.10.2000
“PËR PUSHTETET DHE AUTORITETET E KOMANDIMIT E TË DREJTIMIT
STRATEGJIK TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

““Komandë mbështetëse” nënkupton komandën e mbështetjes logjistike dhe komandën e doktrinës dhe të stërvitjes.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “politikës së mbrojtjes” shtohen fjalët “strategjisë ushtarake”.
2. Në pikën 5, pas fjalës “vendos” shtohen fjalët “me ligj”.

Neni 3

Në nenin 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 hiqen fjalët “shpërndarjen e” dhe në vend të tyre shtohen fjalët “planin e vendosjes dhe përhapjes së”.
2. Në fund të pikës 7 shtohen fjalët “me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes”.
3. Në pikën 8, pas fjalës “emëron” shtohet fjala “gradon”.

Neni 4

Në nenin 13 pika 5 emërtimi “Ministri i Pushtetit Lokal” zëvendësohet me emërtimin “Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit” .

Neni 5

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “si dhe zbatimin e tyre në kohë paqeje” zëvendësohen me fjalët “si dhe projektligje të tjera, të nevojshme për funksionimin efektiv të Forcave të Armatosura” .
2. Në pikën 6 fjalët “me pagesë” zëvendësohen me fjalët “profesionistë dhe rekrutëve” dhe pas fjalëve “Forcat e Armatosura” shtohen fjalët “me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes” .
3. Në fund të pikës 16 shtohen fjalët “bazuar në propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.”

Neni 6

Në nenin 16 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 5 shfuqizohet.
2. Në fund të pikës 6 shtohen fjalët “me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes”.
3. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:
“ 9. Bashkërendon punën ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe ministrive të tjera për kontrollin e hapësirës ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë.”
4. Në pikën 10, fjalët “Ministrisë së Pushtetit Lokal” zëvendësohen me fjalët “Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit” .

Neni 7

Në nenin 17 bëhen këto shtesa e ndryshime:

Pas fjalëve “politikës së mbrojtjes” shtohen fjalët “strategjisë ushtarake.”

Neni 8

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
“1. I paraqet Këshillit të Ministrave projektin e dokumentit të politikës së mbrojtjes dhe të strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë dhe projektet që kanë të bëjnë me funksionimin efektiv të Forcave të Armatosura.”
2. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:
“7/1. Emëron dhe shkarkon, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, drejtorët e drejtorive ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm, me përjashtim të atyre që mbajnë gradën e gjeneralit”.
3. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:
“9. I propozon Presidentit dhënien e gradave madhore ushtarakëve, sipas ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
4. Pas pikës 20 shtohen pikat 21 dhe 22 me këtë përmbajtje:
“21. Propozon dhe zhvillon politika për integrimin e Forcave të Armatosura në strukturat euroatlantike.
22. I delegon autoritet, me akt të shkruar, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, komandave vartëse dhe komandave mbështetëse në fushën e menaxhimit të personelit.” .

Neni 9

Në nenin 20, pas fjalëve “Zëvendësministri i Mbrojtjes” shtohen fjalët “Sekretari i Përgjithshëm” dhe pas fjalëve “Komandanti i mbështetjes logjistike” shtohen fjalët “Drejtori i Politikave të Mbrojtjes dhe Integritetit”.

Neni 10

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, nënparagrafi i dytë formulohet si më poshtë:

“- planifikimin, programimin dhe buxhetimin e mbrojtjes; vlerësimin strategjik të kërcënimeve a të rreziqeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre;”.

2. Në nënparagrafin e tretë, pas fjalës “drejtimin” shtohen fjalët “e komandimin”.

Në fund të nenit shtohet një nënparagraf me këtë përmbajtje:

“- zhvillimin e komisioneve të unifikuara të gradës e karrierës për për zgjedhjen, nxjerrjen në lirim, rezervë, shkarkimin nga detyra të oficerëve dhe nënoficerëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit”.

Neni 11

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Në kohë lufte, Shtabi i Përgjithshëm vepron si shtab për Presidentin dhe Komandantin e Forcave të Armatosura.”.

Neni 12

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është përgjegjës përpara Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes për komandimin e Forcave të Armatosura. Ai drejton përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, siguron plotësimin me personel, si dhe merr drejtimin dhe organizimin e veprimeve ushtarake dhe joushtarake.”.

Neni 13

Në fund të nenit 28 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nxjerr urdhra dhe udhëzime brenda përgjegjësi dhe detyrave që ka;

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, në raste të veçanta delegon, me shkrim, autoritet Zëvendësshefit të Shtabit të Përgjithshëm.”.

Neni 14

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Në nënparagrafin e pestë të paragrafit të parë hiqet fjala “afatgjatë”.

2. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Shefi i Shtabit të Përgjithshëm ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi:

- kontrollon zbatimin e shpërndarjes së fondeve buxhetore për nevojat e Forcave të Armatosura;

- mbikëqyr gatishmërinë luftarake dhe merr masa për përmirësimin e saj;
- organizon dhe mbikëqyr marrjen e masave për gatishmërinë e Forcave të Armatosura dhe, nëse është e nevojshme, merr masa për rritjen e gatishmërisë;
- bën mobilizimin e Forcave të Armatosura kur kjo gjë urdhërohet nga autoriteti përkatës;
- kryen mbështetjen logjistike për Forcat e Armatosura;
- menaxhon personelin e Forcave të Armatosura, në përputhje me politikat e personelit të Ministrisë së Mbrojtjes;
- planifikon zhvillimin profesional të oficerëve dhe nënoficerëve të Forcave të Armatosura;
- planifikon, organizon dhe drejton veprimtaritë përgatitore për Forcat e Armatosura;
- organizon dhe realizon kryerjen e komunikimit (ndërlidhjen) për komandimin dhe kontrollin e Forcave të Armatosura;
- organizon përmbushjen e vërtetimit, të kontrollit dhe sigurisë së paprekshmërisë së hapësirës ajrore, tokësore dhe detare të Republikës së Shqipërisë;
- organizon përmbushjen e veprimtarisë së zbulimit;
- organizon kryerjen e veprimtarisë për mbrojtjen e forcës në Forcat e Armatosura;
- organizon punën për parandalimin, zbulimin dhe dokumentimin e veprimtarive kriminale në Forcat e Armatosura;
- realizon bashkëpunimin me forcat e armatosura të vendeve të tjera, në përputhje me planin e Ministrisë së Mbrojtjes;
- emëron dhe shkarkon oficerët sipas delegimit, me akt të veçantë, nga Ministri i Mbrojtjes.
- i propozon Ministrisë së Mbrojtjes modelin e uniformës ushtarake, sipas llojit të forcës dhe të shërbimit, të gradave dhe të shenjave që vendosen në uniformë.

Përveç përgjegjësisë të përcaktuara në këtë ligj, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm ushtron edhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore të veçanta, si dhe ato të deleguara.”.

Neni 15

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 16

Në titullin e kreut VIII shtohen fjalët “DHE KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE” .

Neni 17

Në fund të nenit 34 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Komandimi dhe drejtimi i efektivave të komandës së mbështetjes logjistike dhe të komandës së doktrinëve dhe të stërvitjes realizohen nga komandanti i komandës përkatëse.” .

Neni 18

Pika 1 e nenit 35 ndryshohet si më poshtë:

“1. Komandanti i forcës dhe komandanti i komandës mbështetëse përgjigjen për gjendjen, menaxhimin e personelit, përgatitjen, mobilizimin, gatishmërinë luftarake, drejtimin operacional për zhvillimin e doktrinës, të parimeve, të operacioneve, të planifikimit, të programimit dhe të pajisjes e të modernizimit të forcës ose të komandës mbështetëse.” .

Neni 19

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Komandanti i forcës dhe komandanti i komandës mbështetëse janë këshilltarët më të lartë kryesorë ushtarakë të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për forcën (komandën) që drejton. Komandanti i forcës dhe komandanti i komandës mbështetëse raportojnë edhe drejtpërdrejt te Ministri i Mbrojtjes.”.

Neni 20

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

Komandanti i forcës dhe komandanti i komandës mbështetëse kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- paraqesin te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm doktrinën e forcës a të komandës që drejtojnë;
- miratojnë manualët e luftimit dhe të teknikës për forcën a komandën që drejtojnë;
- paraqesin planet afatgjata dhe programet vjetore për forcën a komandën që drejtojnë;
- paraqesin planin e veprimeve të forcave nën komandë për kohë paqeje, gjendje të jashtëzakonshme dhe për gjendje lufte;
- paraqesin projektbuxhetin vjetor të forcës a komandës;
- propozojnë dekorimin dhe gradimin jashtë radhe të personelit vartës;
- emërojnë e shkarkojnë oficerët kur i delegohet, me akt të veçantë të Ministrit të Mbrojtjes;
- paraqesin te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm planet afatgjata dhe programet e buxhetit vjetor për komandën që drejtojnë;
- i paraqesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm projektet për strukturën e forcës a të komandës që drejtojnë dhe propozojnë ndryshimet e mundshme;
- paraqesin projektprogramet e përgatitjes dhe ato për kualifikimin e personelit, brenda dhe jashtë vendit;
- përmbushin përgjegjësitë për dhënien e dekoratave dhe të medaljeve;
- sigurojnë që sistemi i vlerësimit të oficerëve dhe nënoficerëve të zbatohet me përpikmëri në komandë, në përputhje me ligjin dhe politikën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm;
- emërojnë, gradojnë dhe shkarkojnë ushtarët profesionistë dhe nënoficerët, sipas ligjit.

Përveç përgjegjësiave të përcaktuara në këtë ligj, komandanti i forcës dhe komandanti i komandës mbështetëse ushtrojnë edhe përgjegjësi të tjera, të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore të veçanta ose të deleguara.”.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4173, datë 15.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9197, datë 26.2.2004

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.171 “MBI PUNËN E NATËS”, 1990
TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.171 “Mbi punën e natës”, 1990 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4178, datë 23.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
MBI PUNËN E NATËS (NR.171)

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga organi qeverisës i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe e mbledhur në sesionin e 77 të saj, më 6 qershor 1990:

duke vënë re dispozitat e konventave dhe rekomandimeve ndërkombëtare të punës mbi punën e natës së fëmijëve dhe personave të rinj në moshë dhe veçanërisht klauzolat në Konventën dhe rekomandimin mbi punën e natës të personave të rinj (profesionet joindustriale, 1946, Konventën (Industriale) të punës së natës të personave të rinj (e riparë), 1948 dhe rekomandimin (bujqësor) të punës së natës së fëmijëve dhe personave të rinj, 1921;

duke vënë re dispozitat e konventave dhe rekomandimeve të punës ndërkombëtare mbi punën e natës së grave dhe veçanërisht klauzolat në Konventën e punës së natës (së grave) (e riparë), 1948 dhe protokollin e 1990 për sa më sipër, rekomandimin (bujqësor) të punës së natës së grave, 1921 dhe paragrafit 5 të rekomandimit të mbrojtjes së amësisë, 1952 dhe

duke vënë re dispozitat e Konventës (së punësimit dhe profesionit) së diskriminimit, 1958;

duke vënë re dispozitat e Konventës së mbrojtjes së amësisë (rishikuese), 1952;

duke vendosur mbi miratimin e disa propozimeve lidhur me punën e natës, e cila është pika e katërt në axhendën e sesionit;

duke vendosur që këto propozime do të marrin formën e një konvente ndërkombëtare,

miraton sot, më 26.6.1990 Konventën e mëposhtme, e cila mund të citohet si Konventa e punës së natës 1990.

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Termi “punë nate” do të nënkuptojë të gjithë punën që kryhet gjatë një periudhe prej jo më pak se shtatë orë të njëpasnjëshme, duke përfshirë intervalin nga mesnata gjer më 5 të mëngjesit, që do të vendoset nga autoriteti kompetent pas konsultimit me organizatat më përfaqësuese të punësuesve dhe punëtorëve ose me marrëveshje të përbashkëta;

Konventa nuk kish hyrë në fuqi gjer më 1 shtator 1991.

b) Termi “punëtor nate” nënkupton një person të punësuar, puna e të cilit kërkon kryerjen e një numri të mjaftueshëm orësh të punës së natës që tejkalon kufirin e përcaktuar. Ky kufi do të fiksohet nga autoriteti kompetent i konsultimit me organizatat më kompetente të punësuesve dhe të punëtorëve me marrëveshje të përbashkëta.

Neni 2

1. Kjo Konventë u drejtohet të gjithë personave, përveç atyre të punësuar në bujqësi, blegtori, peshkim, transportin detar dhe lundrimin e brendatokës.

2. Një anëtar që ratifikon këtë Konventë, pasi të konsultohet me organizatat përfaqësuese përkatëse të punësuesve dhe të punëtorëve, mund të përjashtojë tërësisht ose pjesërisht nga fusha e veprimit të saj kategori të kufizuara punëtorësh, kur zbatimi i Konventës ndaj tyre do të nxirrte mjaft probleme të jashtëzakonshme.

3. Çdo anëtar që përfiton nga mundësia e ofruar në paragrafin 2 të këtij neni duhet që, në raportin e tij të aplikimit për në Konventë në nenin 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të paraqesë kategoritë e veçanta të punëtorëve kësajsoj të përjashtuar dhe arsyet për përjashtimin e tyre. Gjithashtu duhet të përshkruajë të gjitha masat e marra që kanë si qëllim të zgjerojnë vazhdimisht dispozitat e Konventës për punëtorët përkatës.

Neni 3

1. Masa të veçanta që kërkohen nga natyra e punës së natës, që do të përfshijë si minimum, ata që përmenden në nenet 4 dhe 5, do të merren për punëtorët e natës, me qëllim që të mbrohet shëndeti i tyre, të ndihmohen për të mbuluar përgjegjësitë e tyre familjare dhe shoqërore, të krijohen mundësi për përparim profesional dhe t'i kompesojë ata siç e meritojnë. Masa të tilla do të merren gjithashtu në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes së amësisë, për të gjithë punëtorët që kryejnë punë nate.

2. Masat që i referohen paragrafit 1 më sipër mund të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 4

1. Me kërkesë të tyre punëtorët do të kenë të drejtë t'i nënshrohen një kontrolli mjekësor pa pagesë dhe të marrin këshilla, se si të pakësojnë ose të evitojnë problemet e shëndetit, që lidhen me punën e tyre:

a) përpara se të përcaktohen si punëtorë nate;

b) në intervale të rregullta gjatë kohës së mbajtjes së këtij përcaktimi;

c) nëse pësojnë probleme shëndeti gjatë këtij përcaktimi, që nuk shkaktohen nga faktorë të ndryshëm nga kryerja e punës së natës.

2. Me përjashtim të një vendimi paaftësie për punë nate, vendimet e përcaktimeve të tilla, nuk do t'u transmetohen të tjerëve, pa miratimin e punëtorëve dhe nuk do të përdoren në dëm të tyre.

Neni 5

Punëtorëve që kryejnë punë nate, do t'u ofrohen lehtësira të ndihmës së parë, duke përfshirë edhe parapërgatitje që, punëtorët, aty ku është e nevojshme, mund të çohen shpejt në një vend ku mund t'u ofrohet kurimi i përshtatshëm.

Neni 6

1. Punëtorët e natës, të pajisur me certifikatë si të papërshtatshme nga ana shëndetësore për punë nate, do të transferohen, kurdoherë kur kjo është e zbatueshme, në një punë të ngjashme për të cilën ata janë të aftë.

2. Nëse transferimi në një punë të tillë nuk është i realizueshëm, këtyre punëtorëve do t'u garantohen të njëjtat përfitime si punëtorëve të tjerë, që janë të paaftë të punojnë ose të sigurojnë punësim.

3. Një punëtori nate të certifikuar si përkohësisht i papërshtatshëm për punën e natës, do t'i jepet e njëjta mbrojtje kundër pushimit ose paralajmërimit për pushim, ashtu si dhe punëtorëve të tjerë që u ndalohe punësimi për arsye shëndeti.

Neni 7

1. Duhet të merren masa që të sigurojnë që një mundësi për punë nate është e vlefshme dhe për punëtorët gra, që do t'u lypet nevoja të kryejnë një punë të tillë:

a) para dhe pas lindjes, për një periudhë prej të paktën gjashtëmbëdhjetë javësh prej të cilave tetë javë do të jenë para datës së parashikuar të lindjes;

b) për periudha shtesë, në lidhje me të cilat paraqitet një certifikatë mjekësore, që deklaron se është e nevojshme për shëndetin e nënës ose të fëmijës:

i) gjatë shtatzënisë,

ii) gjatë një kohe të specifikuar pas lindjes së fiksuar, në përputhje me nënparagrafin (a) sipër, gjatësia e së cilës do të vendoset nga autoriteti kompetent pas konsultimit me organizatat më përfaqësuese të punësuesve dhe punëtorëve.

2. Masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni mund ta përfshijë kalimin në punë dite, kur kjo është e mundur, klauzolën e përfitimit të sigurisë shoqërore ose të zgjatjes së lejes së lindjes.

3. Gjatë periudhës së përmendur në paragrafin 1 të këtij artikulli:

a) Një punëtoe grua nuk do të pushohet e as do t'i jepet paralajmërim për pushim, përveç arsyeve të përligjura që nuk lidhen me shtatzëninë ose lindjen.

b) E ardhura e një punëtoe grua do të mbahet në një nivel të mjaftueshëm për mbajtjen e vetes dhe të fëmijës së saj, në përputhje me një standard të përshtatshëm jetese. Kjo ruajtje e të ardhurës mund të sigurohet nga çdonjëra prej masave të radhitura në paragrafin 2 të këtij neni, nga masa të tjera të përshtatshme ose nga një kombinim i këtyre masave.

c) Një punëtoe grua nuk do të humbasë përfitimet, lidhur me statusin, vjetërsinë dhe mundësinë për ngritje në detyrë, e cila mund t'i bashkëngjisë një pozicion pune nate.

4. Klauzolat e kësaj pike nuk do të ndikojnë në zvogëlimin e mbrojtjes dhe përfitimeve që lidhen me lejen e lindjes.

Neni 8

Kompensimi për punëtorët e natës në formën e kohës së punës, pagesës ose përfitimeve të ngjashme do të shquajë natyrën e punës së natës.

Neni 9

Punëtorëve të natës, dhe kur është e nevojshme dhe atyre që kryejnë punë nate, do t'u ofrohen shërbime shoqërore të përshtatshme.

Neni 10

1. Para se të paraqesin planet e punës që kërkojnë shërbimet e punëtorëve të natës, punësuesi do të konsultohet me përfaqësuesit e punëtorëve që kanë të bëjnë me detajet e planeve të tilla, formave të organizimit të punës së natës që i përshtaten sa më mirë ndërmarrjes dhe personelit,

si dhe me masat shëndetësore profesionale dhe shërbimet shoqërore që kërkohen. Në ndërmarrjet që punësojnë punëtorët e natës, ky konsultim duhet të ndodhë rregullisht.

2. Për qëllimet e këtij neni “përfaqësuesit e punëtorëve” do të thotë persona që njihen si të tillë nga ligji e praktika kombëtare, në përputhje me Konventën e përfaqësueve të punëtorëve, 1971.

Neni 11

1. Dispozitat e kësaj Konvente mund të implementohen nga ligje ose rregullore, marrëveshje të përbashkëta, vendime të arbitrave apo vendime gjyqi, një kombinim i këtyre mjeteve ose me ndonjë mënyrë tjetër që shkon me kushtet dhe praktikat kombëtare. Përderisa atyre nuk u është dhënë fuqi nga mënyra të tjera, ato do të zbatohen me ligje dhe rregullore.

2. Kur dispozitat e kësaj Konvente zbatohen nga ligje ose rregulime duhet që të bëhen konsultime me organizatat më përfaqësuesve të organizatave të punësuesve dhe punëtorëve.

Nenet 12-19

Dispozitat standarde finale

STANDARDI I DISPOZITAVE TË FUNDIT

1. Ratifikimet

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente do t’i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës së Punës për regjistrim.

2. Hyrja në fuqi

1) Kjo Konventë do të ketë fuqi vetëm mbi ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar nga drejtori i përgjithshëm.

2) Kjo do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës kur ratifikimi i dy anëtarëve është regjistruar nga drejtori i përgjithshëm.

3) Pas kësaj, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo anëtar, 12 muaj pas datës që është regjistruar ratifikimi.

3. Denoncimi

1) Një anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë, kur kanë mbaruar dhjetë vjet që prej datës kur Konventa ka hyrë në fuqi për herë të parë, me një dokument drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Denoncime të tilla nuk do hyjnë në fuqi para një viti që prej datës së regjistrimit të tyre.

2) Çdo anëtar që ka ratifikuar Konventën dhe brenda vitit që pason skadimin e periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin paraardhës, nuk ushtron të drejtën e denoncimit që i jepet nga ky nen, do të jetë i lidhur edhe për dhjetë vjet të tjera, dhe pas kësaj mund ta denoncojë këtë Konventë në mbarimin e çdo periudhe prej dhjetë vjetësh, nën kushtet e dhëna në këtë nen.

4. Njoftim i ratifikimit të anëtarëve

1) Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do të njoftojë të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i janë komunikuar nga anëtarët e Organizatës.

2) Gjatë vënies në dijeni të anëtarëve të Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i është komunikuar, Drejtori i Përgjithshëm do t’u tërheqë vëmendjen anëtarëve të Organizatës për datën që Konventa do të hyjë në fuqi.

5. Komunikimi me Kombet e Bashkuara

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t’i komunikojë Kryetarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të regjistrimit, në përputhje në nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, një raport të hollësishëm për të gjitha ratifikimet dhe aktet e denoncimit të regjistruara nga ai në përputhje me dispozitat e neneve pararendëse.

6. Shqyrtimi i rishikimit

Në raste që mund ta quajë të arsyeshme, Trupi Qeverisës i Zyrës Ndërkombëtar të Punës do t'i paraqesë konferencës së përgjithshme një raport mbi mbarëvajtjen e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë vullnetin për të vendosur në axhendën e konferencës, çështjen e rishikimit tërësor ose të pjesshëm.

Vini re: Në konventat me numra: 1-98 kjo klauzolë luante rolin e raporteve të Trupit Qeverisës më çdo dhjetë vjet pas hyrjes në forcë. Ajo u zëvendësua në këto konventa me tekstin e tanishëm, sipas kushteve të Konventës së Rishikimit të neneve finale, 1961 (Nr.116).

7. Efektet e Konventës rishikuese

1. Nëse konferenca do të miratonte një konventë të re që do të rishikonte këtë Konventë tërësisht ose pjesërisht, atëherë vetëm përveç rasteve kur konventa e re e parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re së rishikuar do të sjellë *ipso jure* denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht dispozitave të nenit 3 më sipër, asaj se ku dhe kur Konventa rishikuese e re duhet të ketë hyrë në forcë;

b) që prej datës kur konventa e re e rishikuar do të hyjë në fuqi, kjo Konventë do të pushojë së qeni e hapur për ratifikimet e anëtarëve.

2. Kjo Konventë sidoqoftë, do të qëndrojë në fuqi me formën dhe përmbajtjen aktuale për ata anëtarë që e kanë ratifikuar, por s'kanë ratifikuar konventën e riparë.

Vini re: Kjo klauzolë nuk shfaqet në konventat nr.1-26. Konventat nr.27-33 nuk përmbajnë fjalët "atëherë, vetëm përveç rasteve kur konventa e re e parashikon ndryshe".

8. Tekstet e besueshme

Versionet në anglisht dhe frëngjisht të teksteve të kësaj Konvente janë njësoj të besueshme.

Vini re: Në konventat nr.1-67 kjo klauzolë lexon "Tekstet angleze, franceze do të jenë autentike".

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 26.3.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë